



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 15.4.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit- UNICEF.

I ftuar: Arsim Gërxhaliu- udhëheqës i Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Edona Tolaj – YIHR; Selvete Gërxhaliu – GDNJD; Albert Selimi dhe Teuta Hoxha-YIHR KS; Vlora Nushi-UNMIK/OPA; Qëndrim Imeri-INFODIREKT.TV; Përparim Bublaku-Lajm.net; Nebih Maxhuni-Radio Dukagjini; Beadin Sylja-Kosovapress; Minire Krasniqi-Kosova Sot; Visar Bivolaku-EUO/EUSR Sakibe Jashari- Ambasada e Zvicrës dhe Arta Xhylani- praktikante, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 09;
3. Miratimi i rekomandimeve lidhur me peticionin për zbardhjen e fatit të Mr.Ukshin Hotit,
(I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është, z. Arsim Gërxhaliu, udhëheqës i Departamentit të Mjekësisë Ligjore);
4. Miratimi i vendimit për përsëritjen e konkursit për Avokat të Popullit;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, me katër vota për dhe tre kundër, dhe në pikën të ndryshme, të diskutohet për rekomandimet e peticionit për shtrenjtimin e energjisë elektrike.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 09

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25.3.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i rekomandimeve lidhur me peticionin për zbardhjen e fatit të Mr.Ukshin Hotit (I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është, z. Arsim Gërxhaliu, udhëheqës i Departamentit të Mjekësisë Ligjore)

Teuta Haxhiu, ngriti shqetësimin për mosftesën në këtë mbledhje edhe të z.Prenk Gjetaj, kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, sepse tha se duhet t'i dëgjojmë të dy palët, se me çfarë problemesh ballafaqohen, sepse veçmas nuk mund të sqarojmë asgjë.

Kryetarja, tha se z.Gjetaj ishte në një mbledhje më herët, ndërsa sot është z. Gërxhaliu për të plotësuar pjesën tjetër. Do të ishte më mirë të ishin bashkë, por meqenëse herën e kaluar nuk i kishim të dy bashkë, kemi vendosur që sot të jetë z. Gërxhaliu, për të mos e munduar z.Gjetaj dy herë.

Teuta Haxhiu, unë kam kërkuar që të jetë edhe z.Gjetaj dhe për këtë janë incizimet, sepse kemi shumë çështje që duhet t'i debatojmë në prezencën e të dy palëve.

Kryetarja, falënderoi z. Gërxhaliu që iu ka përgjigjur ftesës së Komisionit dhe ftoi që të marrë fjalën.

Arsim Gërxhaliu, fillimisht prezantoi një kronologji të funksionimit të punës së Komisionit Qeveritar dhe ekspertëve të mjekësisë ligjore, që nga koha e pasluftës dhe me problemet që janë ballafaquar fillimisht.

Ekipet e Tribunalit të Hagës kanë ekzaminuar 4019 raste, kurse me dhjetëra shtete kanë marrë pjesë në vende të caktuara, por në atë kohë nuk është punuar me mjete të sofistikuar dhe dokumentacioni mungon dhe nuk përjashtohet mundësia e gabimeve në atë kohë.

Në vitin 2002, nën administrimin e UNMIK-ut, u krijua Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, me bazë në Rahovec, dhe nga aty fillohet një punë më profesionale ku hynë në punë edhe identifikimi përmes metodës së ADN-së. ICMP- Komiteti Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur e ka bazën në Sarajevë dhe në Tuzull, ku analizat bëheshin falas. Po ashtu, u bë një memorandum mes UNMIK-ut dhe ICMP-së. Në këtë kohë, kemi filluar me gati 6 mijë raste, me numër të personave të identifikuar në Zyrën e Personave të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore dhe tani jemi në numrin prej 1655 rastesh. Nuk kemi pasur ndonjë tretman të duhur. Në vitin e kaluar, për herë të parë, janë blerë disa rroba për punë në terren, kurse në këto 16 vite kemi pasur një donacion prej ambasadës së Zvicrës, sidomos në lokacionin e Zhilivodës, me një shumë prej 50 mijë eurove. Po ashtu falënderoj ambasadën Belge, e cila ka ndarë një shumë prej 265 mijë eurosh për ngritjen e kapaciteteve lokale për trajnime në secilën lëmi të Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Kemi pasur mangësi për dy antropologë, të cilët i kemi punësuar që dy vite, ndërsa kemi një sasi të mjeteve prej grandit belg, por kemi pak vështirësi për trajnim dhe certifikim, sepse në Kosovë nuk ka pasur antropologë që mund t'i trajnojnë, si dhe jemi ballafaquar me gjëra specifike që nuk i kemi pasur asnjëherë. Prej vitit 2006, kemi bërë kërkesë që të kemi laboratorin e ADN-së, por kemi hasur në rezistencë nga ndërkombëtarët, me pretekst se ekziston Agjencia e Policisë, e cila e ka laboratorin e ADN-së. Po ashtu, kemi probleme me analiza të ADN-së. Këtë e kam cekur edhe në takimin me kryeministrin, sepse ICMP-ja ka filluar gradualisht tërheqjen nga Ballkani. Ne kërkuam që Qeveria të ndërhyjë, sidomos për rastin e Qabratit, në grupin punues, i cili është në kontakt me palën serbe dhe ende është i përfaqësuar anëtar i UNMIK-ut, sepse ende punohet me memorandumin që nga koha e UNMIK-ut.

Takimet me palën serbe organizohen nën mbikëqyrjen e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, që prej vitit 2004, prej 1655 personave të zhdukur, afër 500 janë jo shqiptarë. Sa i përket fatit të Ukshin Hotit, unë në çdo takim e kam ngritur fatin e tij dhe jemi të detyruar që çdo informacion dhe lokacion ta hulumtojmë. Në pjesën e dytë të majit do t'i kontrollojmë tri basene jashtë Dubravës dhe një brenda Dubravës, sepse ka informacione se mund të jetë edhe në ato basene. Kemi kërkuar që të bëhet hapja e arkivit të policisë dhe ushtrisë serbe, sepse ata çdo gjë e kanë pasur të komanduar dhe vazhdimisht bëjmë presion për këtë, por këtë nuk mund ta realizojmë, pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar.

Me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, jemi më mirë se çdo vend i botës dhe rajonit që ka pasur konflikt dhe nuk është që në këtë proces nuk kemi pasur rezultat.

Kemi 2000 raste që familjarët e vet i kanë varrosur vetëm në bazë të asaj çka kanë dëgjuar, pa analiza të ADN-së dhe aty është e mundur të bëhen gabime.

Kryetarja, ne na intereson të dimë për bashkëpunimin e Departamentit Ligjor me Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur dhe takimet që bëhen me palën serbe. Pra, a janë të nivelit të njëjtë me delegacionin e palës kosovare?

Arsim Gërxhaliu, grupi punues dialogues i palës serbe, është në nivelin e njëjtë me palën tonë, bazuar në memorandumun e UNMIK-ut dhe palës serbe, të nënshkruar në vitin 2004.

Mytaher Haskuka, tha se prej 6000 mijë personave, 4000 janë identifikuar. U tha që nga 12 raste, 8 kanë rezultuar që kanë qenë gabim dhe për rastin e Ukshin Hotit në peticion, nuk ceken kërkesat se çka të veprojmë ne si Komision, prandaj çka mundemi ne si komision të ndërmarrim dhe ta shtyjmë procesin përpara.

Arsim Gërxhaliu, rasti i 12 personave në Mitrovicë, është grup tjetër. Pra, e cekëm që kemi 2000 persona të varrosur, pa asnjë analizë të bërë. Po ashtu, kemi një grupim të njerëzve që nuk dëshirojnë të japin gjak. Gjithashtu, kemi edhe grupimin tjetër që nuk kanë humbur shpresën dhe ende mendojnë se familjarët e tyre mund të gjinden të gjallë diku. Kontributi i juaj mund të jetë kontakti me familjarë për t'i bindur për dhënien e gjakut.

Mexhide Mjaku-Topalli, u potencuan pengesa të ndryshme në procesin e identifikimit të personave të zhdukur, siç ishin ekspertet mjeko-ligjor, antropologët dhe shumën që e ceke, pastaj laboratorin e ADN-së, mua më intereson takimi që e keni pasur me kryeministrin, u cekën mbetjet mortore të Qabratit, të dërguara në laboratorin e Tuzllës. Çfarë përgjigje morët, a kishin mundësi si qeveri ta mbulojnë këtë me fond?

Arsim Gërxhaliu, kryeministri ishte i gatshëm për një gjest të tillë, por problemi qëndron diku tjetër, sepse ICMP nuk merr fonde prej Qeverisë, ata punojnë në bazë të donacioneve. Kemi hyrë në muajin e shtatë që nuk është kthyer asnjë analizë për rastin e Qabratit. Zyrtarisht, analizat duhet të kthehen për 4 deri në 6 javë.

Mexhide Mjaku-Topalli, u tha që nuk na lejohet ta kemi një laborator. Nga kush vijnë pengesat?

Arsim Gërxhaliu, takimet bëhen gjithnjë me prezencën e ndërkombëtareve. Secili shtet thuajse i ka nga dy laboratorë. Për anën mjekësore kemi një ndërtesë, të cilën e kemi ndërtuar, por nuk kemi mjete dhe staf dhe nuk u lejua që Kosova të ketë dy laboratorë.

Hetem Arifi, tha se profesori me punën që ka bërë, është për çdo lëvdatë, në krahasim me mbështetjen që ka pasur nga Qeveria. Shpresoj se ne si Komision, do të mund të bëjmë diçka që t'ju japim kurajë që të punoni dhe sa më shpejt, të mbyllet ky proces.

Salihe Mustafa, tha se memorandumun është i vitit 2004 dhe se është një përfaqësues i UNMIK-ut. Ne si Komision, unanimisht, do t'ju ndihmojmë. Pyeti: A keni tentuar që ky memorandum të ndërrohet, pasi që UNMIK-u nuk është më, kush janë ata antropologë që

shërbejnë dhe a paguhen ata? A janë të EULEX-it, sepse nuk e dimë nëse paguhen ekstra? Do të ishte më mirë që ne të investojmë në ekspertët tanë, sesa të paguajmë të tjerët. Ne, si Komision, do të tentojmë që ndoshta me rishikim të buxhetit, të keni ju një pjesë të buxhetit, kur keni nevojë.

Arsim Gërxhaliu, për ndryshim të memorandumit kemi kërkuar vazhdimisht. Ekspertët e EULEX-it, që dy muaj, kanë filluar me punën praktike dhe teorike për të bërë trajnimin e tyre, por certifikimi duhet të jetë prej ndonjë institucioni të jashtëm, sepse EULEX-i është mision, nuk është institucion që certifikon.

Teuta Haxhiu, tha se për memorandumin e vitit 2004, tani po dëgjon dhe se duhet të ndryshohet. Ajo pyeti se sa është bashkëpunimi me zyrtarët për persona të pagjetur nëpër komuna, a keni shifra të sakta sa persona serbë janë të zhdukur, sepse është thënë se këto zyra në nivel lokal, nuk kanë evidencë për personat serbë të zhdukur. Kam njoftim se 25 kërkesa, vetëm para dy dite, janë bërë në Komunën e Pejës nga familjarë të personave të pagjetur, të cilët vijnë dhe kërkojnë një vërtetim për t'ua lëshuar nga zyra e Pejës, se familjari i tyre është i zhdukur dhe këtë e kërkon vetëm me një certifikatë të lindjes.

- A keni evidencë, prej cilës periudhë deri në cilën periudhë janë këta persona? Sepse mund të jetë dyshimi që mund të kërkojë edhe për një person, ndoshta që është gjallë për përfitime tjera. Prenk Gjetaj ka thënë se niveli lokal e ka listën. Unë jam interesuar dhe kam shkuar në Komunën e Pejës dhe zyrtarja më ka thënë se nuk kemi listë.

Arsim Gërxhaliu, disa herë janë ndërruar kryetarët e komisionit. Fillimisht, pala serbe ka thënë se janë të zhdukur diku afër 1450 persona, mbi 500 i kemi gjetur gjallë, e disa të varrosur, por jo nga natyra e luftës. Kosova edhe më tutje nuk e ka listën qendrore të të zhdukurve.

Valdete Bajrami, gjatë fjalimit tuaj e potencuat edhe ndikim politik, të cilin ju e keni vërejtur. A është kjo edhe arsyeja e demoralizimit tuaj?

Po ashtu, u tha që ballafaqoheni me probleme të ndryshme, si financiare, si me trysni tjera, se ju mungon mbështetja minimale. A është ndikimi politik arsyeja kryesore për paralajmërimin për largimin tuaj të ngadalshëm?

Arsim Gërxhaliu, nga partitë politike që kanë qenë në pushtet edhe më herët, por edhe tani, nuk ka pasur ndonjë refuzim. Nga aspekti shpirtëror krejt kanë qenë për, pra që të jenë me ne, por kemi mundur të punojmë më shumë.

Kryetarja, takimi ishte mjaft produktiv me z. Gërxhaliu, pasi që shumë çështje u kuptuan dhe vlera e punës për ne, rritet deri në Kuvend, ndërsa në datën e të pagjeturve, pra më 27.4.2015, në seancën që do të mbahet, si anëtarë të Kuvendit, pra si deputetë, do të paraqiten me fjalët e tyre që do të kontribuojnë pozitivisht në zbardhjen e fatit të të pagjeturve, që së paku të dihen eshtrat e familjarëve të familjeve të vendit tonë. Andaj, në agjendën politike, duhet të jetë një shtytje e madhe për unifikimin e këtyre çështjeve. Komisioni ka edhe rekomandimet e veta, mirëpo nga biseda me z. Gërxhaliu do të

konsultohen anëtarët e Komisionit dhe këto rekomandime, qoftë edhe me plotësime, do të procedohen për në Kuvend.

Arsim Gërxhaliu, tha se që nga viti 2004 kanë bërë kërkesë, pikërisht për z.Hoti, ku në çdo takim është cekur, por kurrë nuk është marrë ndonjë informatë zyrtare prej palës serbe, e që po bëhen 11 vite, vetëm një kërkesë, si kjo e Komisionit, është bërë në vitin 2006 dhe më asnjëherë, edhe pse dihet se kush e ka marrë atë, dihen emrat dhe ka mekanizma që duhet vepruar.

Kryetarja, falënderoi z. Gërxhaliu dhe tha se grupi punues, i kryesuar nga znj. Mexhide, ka harmonizuar rekomandimet, që do të paraqiten tani, mirëpo prania e z. Gërxhaliu, ndoshta do t'ju bëjë që të ndryshojmë ose plotësojmë diçka në këto rekomandime.

Mexhide Mjaku- Topalli, paraqiti para Komisionit rekomandimet lidhur me peticionin për z.Ukshin Hoti.

Teuta Haxhiu, propozoi që në rekomandimin e parë, te pjesa “në agjendën e bisedimeve në baza 6 (gjashtë) mujore”, të jetë që brenda 6 (gjashtë) muajve të jetë si temë në bisedimet me Serbinë, dhe jo siç thuhet çdo 6 (gjashtë) muaj.

Të gjithë u pajtuan që të ndryshohet kjo pjesë.

Kryetarja, tha se në këto rekomandime janë përfshirë të gjitha, qoftë shqetësimet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore apo politike, po ashtu edhe çështja e z.Hoti, për shkak të urdhrave komanduese, që të shikohen procesverbalet e ushtrisë dhe policisë.

Mytaher Haskuka, sugjeroi që të ndryshohet rekomandimi dhe që të thuhet për sigurimin e mekanizmave për funksionalizimin profesional të stafit dhe teknikë adekuate për punë efikase, ai kërkoi që të krijohet edhe fondi brenda Ministrisë së Drejtësisë, sipas nevojës si e parashohin për këto mekanizma, pasi që po shfaqet si çështje qenësore një buxhet jo- adekuat ose buxhet që duhet prituri. Po ashtu, kërkoi edhe ndryshimin e memorandumit të UNMIK-ut.

Kryetarja, propozoi që miratohen rekomandimet nga të gjithë anëtarët e Komisionit, me një ndryshim, pra që të futen edhe fondet si pjesë e mekanizmave profesionale për gjetjet mortore dhe zbardhjen e fatit të z.Ukshin Hotit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi të nxjerrë këto

Rekomandime:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bisedimet Kosovë-Serbi, të kërkojë që brenda gjashtë muajve të përfshihet në agjendën e bisedimeve zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe me Raportin për rezultatet dhe sfidat në këtë proces, të njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, të sigurojë fonde për funksionalizimin e mekanizmave përkatës profesional-teknik, për punë më efektive, për identifikimin e mbetjeve mortore dhe për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.
3. Subjektet bartëse të politikës ndërparlamentare dhe të politikës së jashtme të Kosovës, në agjendat e takimeve me përfaqësuesit e OKB-së, BE-së dhe të shteteve me ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare, të fokusojnë në mënyrë të veçantë dhe me prioritet, zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, në dritën e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe për këtë ta njoftojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës, në baza gjashtëmujore.
4. Të gjithë bartësit e detyrave sipas këtyre rekomandimeve, t'i qasen në mënyrë të veçantë, zbardhjes së fatit të Mr. Ukshin Hotit, për shkak të rrethanave të zhdukjes së tij, të planifikuar nga strukturat komanduese ushtarake-policore të shtetit serb dhe Drejtoria e Burgut të Dubravës në Istog.

5.

4. Miratimi i vendimit për përsëritjen e konkursit për Avokat të Popullit

Mytaher Haskuka, mendon se sipas ligjit, nëse brenda një seance nuk zgjidhet Avokati i Popullit, prapë pas një muaji votohet, deri në 6 muaj dhe nëse nuk zgjidhet gjatë kësaj periudhe, vazhdohet me konkurs të ri. Pra, që brenda 30 ditëve, të vijë e njëjta listë me kandidatë që të votohet në Kuvend.

Kryetarja, tha se nëse pas tri votimeve nuk zgjidhet asnjëri nga kandidatët në Kuvend sipas Kushtetutës, atëherë përsëritet konkursi, mirëpo do të ishte më mirë të rishikohet edhe një herë ligji që të mos keni hamendje dhe moskuptime, sepse nuk duhet humbur kohë me gjërat që duhet të ishin ditur dhe kuptuar.

Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, sqaroi se sipas ligjit dhe Rregullores, përcaktohet që në afat kohor prej 30 ditësh të punës (edhe 30 ditë tjera që mund të jenë pushim për deputetët apo ka ndonjë rast të veçantë në një vit), të ketë votim në Kuvend, përndryshe nëse nuk realizohet, i kthehet Komisionit prapë për procedurë nga fillimi me një përsëritje, e që kjo nuk ka ndodhur në rastin konkret për kandidatët për Avokat të Popullit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, me 7 vota për dhe një abstenim, mori këtë

VENDIM

Përsëritet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

6. Të ndryshme

Diskutim për rekomandimet e petitionit për shtrenjtimin e energjisë elektrike.

Valdete Bajrami, theksoi se nuk dëshiron të ketë keqkuptime me znj. Salihe që po ka ndikim dhe ndërhyrje në fjalën e saj, mirëpo ajo në seancën e kaluar kishte kërkuar që në njërin nga seancat e radhës, të debatohet në Kuvend për çështjen e shtrenjtimit të energjisë elektrike, ndërsa si kërkesë e tyre unike, që seanca e radhës, pas kësaj që ka përfunduar, të hyjnë për debat këto rekomandime, vetëm që edhe të shikohet raporti i ZRRE-së, sepse po dëshmohet edhe mospuna jonë si Komision, ndërsa nëse ka diçka gabim, ajo kërkon sqarim.

Salihe Mustafa, pranon kërkimfaljen nga deputetja Bajrami dhe theksoi se ajo nuk ka folur me direktivat e askujt, sepse ajo u caktua që në seancën e asaj dite të flasë në vend të kryetares së Komisionit.

Teuta Haxhiu, tha se janë pajtuar të hiqet si pikë e rendit të ditës gjatë kësaj seance, por jo për arsyen e raportit të ZRRE-së, por për shkak të disa dilemave në rekomandimet rreth petitionit dhe kërkoi që si Komision, të paraqesin në rend të ditës, në seancën e radhës, pra nesër, këto rekomandime nga peticioni për shtrenjtim të energjisë, sepse nuk humbet asgjë, vetëm të jenë transparentë para të gjithë atyre qytetarëve.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se pasi është shtyrë kjo pikë e rendit të ditës në Kuvend, për shkak të disa rekomandimeve që s'kanë qenë të qarta, pse Komisioni nuk mblidhet në një mbledhje të radhës dhe të procedojë sa më mirë rekomandimet dhe të mos ketë paqartësi, pastaj, ne si Komision, t'i procedojmë për Kuvend.

Kryetarja, tha se e ka parë të arsyeshme, sepse pasi që ka parë raportin e ZRRE-së, ka hasur në shumë informata të tjera që edhe e ka konsideruar të përshtatshme të shtyhet për në kohën e njëjtë, pra në seancë të shqyrtohet edhe raporti, edhe peticioni, sepse edhe deputetët do të ishin më të informuar rreth gjendjes dhe do të ishin më konkretë, pastaj edhe raporti hetimor do t'iu ndihmonte.

Teuta Haxhiu, tha se problemi është se këto rekomandime nuk janë votuar në Komisionin tonë, e që kanë kaluar në seancë, pa u votuar nga ne.

Kryetarja, do t'i shqyrtojmë një nga një rekomandimet dhe të sigurohemi se janë mirë dhe do t'i votojmë.

Mytaher Haskuka, ka diskutim rreth asaj që tregon se votimi për petitionin për zbardhjen e fatit të z.Ukshin Hotit është votuar, sepse nuk kanë pasur kërkesa konkrete nga ana e tyre, pra nuk është ndryshuar asgjë, ndërsa tek peticioni i qytetarëve për shtrenjtimin e energjisë elektrike, kanë 4 kërkesa që të shqyrtohen dhe nuk kërkohet që të ndryshohen këto rekomandime, si dhe nuk e mban mend që është votuar në Komision për këto.

Kryetarja, nuk janë një subjekt Ministria, Komisioni ynë dhe KOSID-i, janë të ndarë, andaj edhe në bazë takimeve të realizuara veçmas, si dhe në bazë të diskutimeve tona dhe

takimeve të Komisionit, kanë rezultuar këto rekomandime, por që nuk kanë dalë nga esenca e kërkesave të peticionit.

Valdete Bajrami, tha se ne si Komision, duhet të fusim disa nga rekomandimet tyre që kanë, krahas rekomandimeve që kanë paraqitur qytetarët e jo të ndryshohen ato të qytetarëve, sepse nuk shihet si efektive, duke anashkaluar rekomandimet e tyre.

Pra, kërkesa e saj është që këtyre rekomandimeve të qytetarëve t'iu shtohen disa rekomandime tona shtesë për seancë.

Kryetarja, pyeti se a e di obligimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe ua rikujtoi që rekomandimet e KOSID-it, Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, janë dërguar, si dhe raporti, por nëse keni kërkuar rishqyrtim, ja ku jemi këtu për të diskutuar edhe një herë për të gjitha. Filloi leximin e rekomandimeve.

Mytaher Kaskuka, nuk pajtohet me rekomandimin e parë, që ka të bëjë me rekomandimet e nxjerra nga rekomandimet e peticionit, sepse kjo bie ndesh dhe lejon të kuptohet se këto janë rekomandimet tona si Komision, ndërsa rekomandimet e qytetarëve nuk po vlejnë, sepse nuk i kanë menduar aq mirë.

Etem Arifi, beson se ende s'e kanë përfunduar punën e tyre, e që po mundohen t'i rekomandojnë dikujt të kryejë punën tyre, andaj të nxirren rekomandimet nga ana e tyre dhe t'i procedojnë.

Valdete Bajrami, kërkoi sqarim për pikën e parë, se a i përfshin të gjitha pikat që paraqet peticioni, pasi që thuhet se përfshihen të gjitha çështjet, sepse pjesa (analizë e detajuar e çmimeve për dy rritjet e fundit) lë të kuptohet që janë përfshirë vetëm dy çështje dhe jo të gjitha kërkesat në peticion, e nëse është kështu, nuk e voton, mirëpo nëse në këtë paragraf përfshihen të gjitha çështjet, atëherë gjithçka është në rregull për të.

Kryetarja, tha se pasi që e kanë të bashkangjitur materialin, analizën dhe peticionin, pika e parë nuk përfshin vetëm disa çështje, po të gjitha, por nëse mendon për ndryshime, gjithçka në rregull.

Kryetarja, pas këtij debati, konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi që rekomandimet për peticionin kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike të mbeten të pandryshuara, ashtu siç janë proceduar në Kryesi.

Teuta Haxhiu, kërkoi votim brenda Komisionit për kërkesën e saj që çështja e peticionit për shtrenjtim të energjisë elektrike të futet si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës, ku seanca do të mbahet nesër (e enjte).

Kryetarja, kërkesën e deputetes Teuta Haxhiu, që çështja e peticionit për shtrenjtim të energjisë elektrike të futet si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës, e hodhi në votim.

Kryetarja konstatoi se me 5 vota kundër dhe 3 vota për, nuk u miratua kërkesa deputetes Teuta Haxhiu, kështu që këto rekomandime do të procedohen në seancë të rregullt.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi